



**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT**  
**AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE**  
**PA1 Nr. 03-279**  
**30.08.2023**  
**Shkup**

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (3) dhe paragrafi (6) dhe nenin 29 të Ligjit për Media ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë " nr. 184/13 dhe 13/14 ), Rregulloren për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e transmetuesve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 30/15), pika 7 dhe 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ar.nr.03-2934/1 datë 24.7.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3274/3 datë 29.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 28-të mbajtur në 29.8.2023 miratoi si vijon:

**Aktvendim**  
**për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik**

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive ( SHTR) RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 15 paragrafi (3) nga Ligji për media (LM) , në mënyrë që transmetuesi në afatin e dytë të parashikuar (më së voni deri më 30 qershor) nuk ka publikuar në programin e tij të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit për vitin e kaluar (reklama, sponsorimin, shitjet e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe nuk ka dorëzuar regjistrim(inçizim) të publikimit në Agjenci në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-2934/1 datë 24.7.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e Ligjit për media.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet (konsiderohet) dita e Çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

**A r s y e t i m**

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe nenit 29 të Ligjit për media, është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të mediave në aspekt të përputhshmërisë së punës (veprimtarisë) së tyre me detyrimet e përcaktuara nga nenet 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë – paralajmërim publik në pajtim me këtë ligj, në rastet kur ka shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të tij, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ kompetent rregullativ mund t'i ndërmarrë, të cilat janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen gjithashtu edhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Në pajtim me nenin 15 paragrafi (3) të LM, transmetuesit janë të obliguar që të dhënat nga paragrafi (1) nënparagrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni t'i publikojnë në programin e tyre, së paku tri herë në vit, në terminet kryesore dhe regjistrim të njoftimit t'i dorëzohet organit rregullativ kompetent në afati prej 15 ditësh nga dita e publikimit në mënyrën e përcaktuar nga ana e organit rregullator kompetent.

Në pajtim me nenin 4 paragrafi (1) nënparagrafi 2 i Rregullores për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e radiodifuzerëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.30/15), transmetuesit janë të obliguar t'i publikojnë të dhënat të paktën tre herë në vit, dhe për herë të dytë t'i publikojnë deri më 30 qershor .

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, më 24 korrik 2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative tek subjekti i mbikëqyrjes, SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, nga ku u konstatua shkelje e nenit 15 paragrafi (3) i LM.

Nga mbikëqyrja e rregullt u konstatua se SHTR RADIO PRO - FM SHPK Gostivar në periudhën e dytë të planifikuar (më së voni deri më 30 qershor) nuk ka publikuar në programin e saj të dhënat për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës dhe burimet e financimit të një viti më parë (reklama, sponzorizim, shitje e përmbajtjeve, shërbimet e ofruara palëve të treta, etj.) dhe nuk ka dorëzuar regjistrimin e njoftimit në Agjenci në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.03-2934/1 datë 24.7.2023, i cili është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli në Agjencia drejtuar SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar, më 26.7.2023, i ka dërguar Shkresë ark.nr.03-2934/2, ku si bashkëngjitime i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative ark.nr.03-2934/1 datë 24.7.2023, me qëllimi që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzoi deklaratë me shkrim për shkeljen kryer të dispozitave nga LM. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga vetë transmetuesi më 8.8.2023. Në afatin e paraparë SHTR RADIO PRO – FM SHPK Gostivar nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 29.8.2023 shqyrtoi raportin me shkrim dhe konstatoi SHTR RADIO PRO - FM SHPK Gostivar duhet t'i shqiptohet masë - vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 15 paragrafi (3) dhe paragrafi 6 dhe nenin 29 të LM, Rregulloren për mënyrën e publikimit të të dhënave për punën e transmetuesve, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raporti me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, ark.nr.03-2934/1 datë 24.7.2023 dhe Konkluzionin nr. 02-3274/3 datë 29.8.2023, dhe për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LM, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën e 28-të mbajtur më 29.8.2023, ka miratuar Aktvendim me të cilin publikisht paralajmëron SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar dhe e urdhërohet që në afat prej 45 (dyzet e pesë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, Agjencia do të kryejë mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij botuesi i medias (transmetuesi) ka të drejtë padie për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit.

Në bazë të gjithë kësaj që është theksuar më lartë, u mor aktvendim si në dispozitiv.

#### **Shtojca (1):**

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative, nr . 03-2934/1 datë 24.7.2023

**Agjencia për Shërbime Mediatike  
Audio dhe Audiovizuale  
Kryetari i Këshillit,  
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.